



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK**

---

Numri i lëndës: 2019:144951

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05875537

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega në Kaçanik, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me procesmbajtësen Azemine Berisha, duke vendosur në çështjen jo kontestimore të propozuesit K. H. E. , të cilën me autorizim e përfaqëson B. L., kundër propozuesit Q. K. (Organi Shpronësues) MMPH Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson A. Z., avokat shtetërore, duke vendosur për caktimin e kompensimit për pasurinë e shpronësuar dhe dëmit të pësuar për pjesën e mbetur jashtë shpronësimit, në seancën publike të mbajtur me datën 13.05.2024, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjygjëse, ndërsa me datën 28.06.2024, bëri përpilimin me shkrim të këtij:

**A K T V E N D I M**

I. REFUZOHET propozimi i propozuesit K. H. E. , i ushtruar me datën 30.01.2018, kundër kundër propozuesit Q. K. (Organi Shpronësues) MMPH Prishtinë, me të cilin ka kërkuar që të caktohet kompensimi dhe të detyrohet kundër propozuesi që të ja paguaj shumën 240,169.00€, në emër të diferencat për pjesën e shpronësua dhe dëmit të pësuar për njësit kadastrale ..., ...dhe ...Zona kadastrale Paldenicë , në tersi SI I PA BAZUAR.

II. Secila palë i përballon shpenzimet e krijuara .

**A r s y e t i m**

I autorizuar e propozuesit, si në propozimin me shkrim edhe në seancat e mbajtura gjyqësore, ka kërkuar nga Gjykata që propozimi të miratohet në tërësi si i bazuar dhe të caktohet kompensimi në shumë prej 240,169.00€, edhe atë në emër të vlerës financiare, diferencës dhe dëmit të pësuar për pjesët e shpronësuar, të ngastrës kadastrale ..., ...dhe ...Zona

kadastrale Paldenicë, të evidentuara në certifikatën e pronës me nr. të lëndës 06-714/10233-2016 ZK- Hani i Elezit.

Pala propozues këtë shumë e ka kërkuar me kamatë prej 7 %, e cila do të paguhet duke filluar nga data e vendimit përfundimtar, e deri në pagesën definitive.

Ka kërkuar që të caktohet kompensimi sepse me rastin e shpronësimit nuk është caktuar çmimi real ashtu siç është përcaktuar me nenin 15 par.1 dhe 2 si dhe nenin 18 par 3, po ashtu nuk është bërë vlerësimi i pjesës së mbetur jashtë shpronësimit i paraparë me Ligjin nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtëshme është paraparë që kompensimi të bëhet në bazë të vlerës së tregut të pronës e cila përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nën ligjore të miratuara në përputhje me paragrafin 6 të këtij neni.

Ka theksuar se çmimi i caktuar nga organi shpronësues nuk është real, e ky fakt është vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit vlerësues B. S. , i cili në ekspertizën e tij ka konstatuar se çmimi real për 1m<sup>2</sup> është 40 € e jo çmimi i caktuar me akt vlerësimin e organit shpronësues i cili është caktuar 1 € /m<sup>2</sup>.

Sa i përket bazës, pala propozuesin propozimin e ka mbështetur në dispozitat materiale të nenit 36 dhe 37 të Ligjit për Shpronësimin, duke i shfrytëzuar të gjitha autorizimet ligjore të cilat ia ka dhënë ligjdhënësi për pjesën reale të paluejtshmërisë së shpronësuar.

Shpenzimet i ka kërkuar, për ekspertizë.

I autorizuari i kundër propozuesit, në propozim dhe në seancat e mbajtura e ka kontestuar në tërësi propozimin e propozuesit për caktimin e kompensimit dhe i ka propozuar gjykatës që propozimin ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Ka theksuar se propozimi i propozuesit duhet të refuzohet, sepse ndërtimi i auto rrugës , është bërë për interes të përgjithshëm publik, e qe i përfshinë edhe qytetarë e Komunës së Hani të Elezit, prandaj nga këto baza propozimi duhet të refuzohet si i pa bazuar.

Për ta vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe gjykuar drejtë këtë çështje jo kontestimore Gjykata me propozimin e të autorizuarve të palëve ndërgjygjëse, në procedimin e provave bëri

marrjen e provave duke bërë leximin e këtyre provave të shkruara : u lexuan vendimi përfundimtar 08/21, akt vlerësimet për njësit kadastrale ..., ...dhe ...Zona kadastrale Paldenicë, raporti i vlerësimit pa vërejtje.

Pas vlerësimit me kujdes dhe me ndërgjegje të provave një nga një dhe të gjithave në tërësi e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të LPK-së ,dhe bindjes së lirë të gjykatës lidhur me këtë çështje jo kontestimore vërtetoi këtë gjendje faktike:

Ngastra e shpronësuar evidentohet në emër të propozueses, është shpronësuar për interes publik, palët në procedurën e shpronësimit nuk kanë mundur të arrin marrëveshje për kompensim. Kompensimi i caktuar nga Organi Shpronësues për parcelën e shpronësuar nuk është bërë në bazë të vlerës së tregut. Vlera reale e ngastërs objekt shpronësimi është caktuar nga ana e ekspertit vlerësues.

Gjykata pas administrimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, dëgjimit të palëve propozimin e propozuesit e refuzoi si të pa bazuar. Këtë propozim e refuzoi, sepse me Ligji nr. 08/L-125 Për Pronën Publik , me Neni 16 paragrafi 1 Bartja e paluajtshmërive në pronësi publike për realizimin e interesit publik është paraparë siç vijon :

Nëse, një pronë e caktuar, e cila është në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes lokale, është e nevojshme për realizimin e një interesi publik të Kosovës, njësia e vetëqeverisjes lokale është e obliguar që këtë pronë t'ia bartë shtetit të Kosovës, pa kompensim. 2. Nëse një pronë e caktuar e cila është në pronësi të Republikës së Kosovës, përkatësisht një Institucioni qendror, është e nevojshme për realizimin e një interesi publik të njësisë së vetëqeverisjes lokale, shteti i Kosovës vlerëson dhe vendosë këtë pronë t'ia bartë njësisë së vetëqeverisjes lokale, pa kompensim. 3. Pas Vendimit për bartje apo refuzim të bartjes, Q. K. ja bashkangjet vlerësimin e interesit publik sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Gjykata i analizoi theksimet e të autorizuarës të propozuesit, i cili i propozoj gjykatës që propozimi të miratohet në tërësi si i bazuar, këtyre theksimeve gjykata gjykata nuk u a dha besimin duke u bazuar në Ligji nr. 08/L-125, Për Pronën Publik , me Neni 16 paragrafi 1, me të cilën dispozitë është paraparë, Nëse, një pronë e caktuar, e cila është në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes lokale, është e nevojshme për realizimin e një interesi publik të Kosovës, njësia e vetëqeverisjes lokale është e obliguar që këtë pronë t'ia bartë shtetit të Kosovës, pa kompensim.

Gjykata i analizoi edhe theksimet e të autorizuarit të kundër propozuesit, i cili i propozoi gjykatës që propozimi për kompensim të refuzohet dhe të mbetet në fuqi vendimi përfundimtarë i Organit Shpronësues. Gjykata këto theksime i mori për bazë me rastin e vendosjes edhe atë duke u bazuar në neni 16.par 1 Ligji nr. 08/L-125, Për Pronën Publik.

Gjykata sa i përket shpenzimeve të procedurës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

## GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

CN.nr.65/18 prej datës 13.05.2024

**Gjyqtari**

Riza LIVOREKA

### KËSHILLA JURIDIKE:

kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate, ankesa paraqitet në kopje të mjaftueshme.

*Exp.me dt.28.06.2024*

*Të autorizuarit të propozuesit 1 x 1*

*Kundër propozuesit 1x1*